

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare kolegji, Nesrin Lushta dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve Tunë Kçira për shkak të veprës penale krim i organizuar nga nenin 274 par.3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (nga viti 2004 në vazhdim KPK), lidhur me veprën penale të detyrimit nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, ndërsa nga viti 2013 edhe në lidhje me veprën penale Fajdeja nga nenin 343 par.3 të KPRK, të akuzuarit K. K., Gj. K., M. K., B. B., Gj..K.1 dhe G. K. për shkak të veprës penale krim i organizuar nga nenin 274 par.1 të Kodit të Përkohshëm penale të Kosovës (nga viti 2004 në vazhdim KPK), lidhur me veprën penale të detyrimit nga nenin 267 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, Z. H., për shkak të veprës penale fajdeja nga nenin 343 par.1 të KPRK, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, B.O. për shkak të veprës penale të detyrimit nga neni 267 par.2 të KPK, T. K., Gj.K., R.F., E.L., H.K., S.K., dhe Z.O., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga nenin 300 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 23 të KPRK, Tunë Kqira, Kastriot Kqira, Benson Buza, Marijon Kqira dhe Gjon Kqira për shkak se kanë kryer veprat penale shpërlarja e parave nga nenin 308 të KPRK, lidhur me nenin 32 par.1 dhe 2 nënpar.2.1 të Ligjit nr.03/L-96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizimit, T.K., B.B., K.K., Gj.K. dhe M.K., secili veç e veç edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 374 par.1 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të akuzuarit B.B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.85/2016 të datës 23.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të akuzuarit B.B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.85/2016 të datës 23.01.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.85/2016 e datës 23.01.2017, të akuzuarve T.K., K.K., B.B., B.O. dhe Gj.K., u ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj e cila do të zgjasë deri më datë

28.03.2017, ndërsa të akuzuarit M.K., ia ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj e cila do të zgjasë deri më datë 24.03.2017. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av. V.H., për shkak se kanë pushuar arsyet nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPK-së, për vazhdimin e paraburgimit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të caktojë ndonjëherë nga masat alternative nga neni 173 të KPPK-së, apo të njëjtin aktvendim ta anuloi dhe lidhur me arsyet e vazhdimin të paraburgimit ndaj të akuzuarit B.B., të caktohet seancë ndëgjimore në gjykatën e shkallës së parë.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi kryesisht thekson se dyshimi i bazuar është një element i cili për arsyetimin e masës së paraburgimit merret për bazë dhe vlerësohet vetëm në fazën fillestare dhe se masa e paraburgimit ka pushuar në momentin e ngritjes së aktakuzës, se janë siguruar të gjitha provat materiale dhe janë dëgjuar pjesa më e madhe e dëshmitarëve, ndërsa pjesa e mbetur e dëshmitarëve janë irelevante për të akuzuarin, se i njëjti gjatë gjithë kohës nuk ka pasur apo manifestuar ndonjë sjellje që do të ngrit një dyshim që ai mund të fshihet apo t'i shmanget procedurës penale, dhe se i njëjti nuk posedon shtetësin e Republikës së Malit të Zi.

Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.15/2017 e datës 22.03.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të akuzuarit B.B. dhe të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penale - juridike nga shkresat e lëndës, kryesisht nga transkriptet e bisedave telefonike të cilat janë siguruar me aplikimin e masave të fshehta teknike dhe të vëzhgimit, nga raportet e policisë, nga deklaratat e dëshmitarëve - të dëmtuarve, vërtetimet mbi konfiskimin e sendeve respektivisht provave tjera të mbledhura gjerr më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari është kryerës i veprës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, për caktimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do

të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale. Sa i përket pretendimit të mbrojtësit të të akuzuarit se masa e paraburgimit duhet të hiqet pasi është ngritur aktakuza ky pretendim nuk qëndron për arsye se, masa e paraburgimit mund të caktohet në çdo fazë të procedurës penale nëse ekzistojnë shkaqet të parapara me nenin 187, e në rastin konkret ende qëndrojnë bazat për vazhdimin e kësaj mase.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK, ngase me lëshimin e të akuzuarit në liri ekziston rreziku i ikjes, fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se vepra me të cilën ngarkohen është e natyrës së rëndë, dhe parashihen dënime mjaft të larta, gjithashtu i akuzuarit B.B. është shtetas i Republikës së Malit të Zi dhe ka një biznes atje, ashtu që për t'iu shmangur përgjegjësisë penale mund të lagohen nga Kosova dhe në këtë mënyrë i njëjti mund të jetë i paarritshëm për organet e ndjekjes dhe kështu do ta pamundësoi zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, fakti se veprat penale janë kryer në bashkëkryerje me një planifikim paraprak, gjatë periudhës disa vjeçare, duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare dhe papërvojën e të dëmtuarve, duke pranuar pasuri materiale ose shuma të shumëfishta të të hollave në këmbim me shumën e huazuar, dhe sipas nevojës kanë përdorur edhe forcën e kanosjen serioze për të detyruar të dëmtuarit që të kryejnë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tyre duke kontraktuar huazimin e shumave të ndryshme financiare me kamata shumë të larta, lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehuve në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale e natyrës se njëjtë.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë edhe aktvendimin duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilën si të drejtë e pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.68/2017, më datë 23.03.2017

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka